




BASHKIA PUKE

PLANI I MBARËSHTIMIT PËR EKONOMINË PYJORE “ GOMSIQE ”

Harta e Ekonomisë Pyjore Gomsiqe
sipas përdorimit e llojeve të bimesisë

N
Shkalla: 1:25.000
Pjesë
Shtetëtare 025
Pjesë Dredh
Ing. Edmond Prandi



Legend	
	Qendra të banuara
	Kufi Ekonomie
Parcela	
Lloji	
	Bujqesore
	Bung
	Inproduktive
	Kullot
	Pish Bung
	Pishe e zeze
	Qarr
	Sallgam
	Shkembore
	Shkurre
	Siperfaqe Boshe
	Siperfaqe me Bimesi Pyjore
	Urbane Bujqesore



BASHKIA PUKE

PLANI I MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVEPËR EKONOMINË PYJORE GOMSIQE (PËR PERIUDHEN 2025 – 2035)

Hartoi

“DREJTORIA E MENAXHIMIT TE PYJEVE E KULLOTAVE DHE BUJQESISE“

Ekipi Punës :

Profesioni Emri/Mbiemri

Ing.Pyjesh	SHKELZEN SULEJMANI
Ing.Pyjesh	ASTRIT HYSENI
Teknik	EMILJANO HERCEKU
Teknik	KUJTIM DELIJA
Gjeodet	PETRIT DODAJ
Agronom	BESMIR LACI

PUKE 2025

Përmbajtia

Përmbajtia.....	0
PJESA E PARË.....	6
1. HYRJE	6
1.1. Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe Kullotave, (PMPK)	6
1.2. Ecuria e punës dhe punës dhe përgjegjësitë	6
1.3. Metodologjia e punës	7
1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK	13
2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË PYJORE.....	13
2.1 Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore	13
2.2 Pronësia, administrimi, organizimi.....	14
2.3. Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative.....	14
2.4. Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore.....	16
2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore	18
2.6. Situata demografike dhe social ekonomike.....	18
2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore	20
2.8. Gjuetia dhe peshkimi.....	21
2.9. Fasilitetet rekreative dhe didaktike	21
3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	22
3.1. Mbarështimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave.....	22
3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)	22
3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet).....	23
3.1.3. Ndarja e ekonomise pyjore ne parcela dhe nenparcela.....	24
3.1.4. Ndarja e pyjeve.....	31
4. KUSHTET STACIONALE.....	31
4.1. Klima.....	31
4.2. Topografia dhe morfologjia.....	34
4.3. Gjeologjia	40
4.4. Tokat.....	Error! Bookmark not defined.
4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me uje.....	43
4.6. Erozioni ne shpate dhe rrjedhiet ujore.....	43
4.7. Rrëshqitjet	43

5.	VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI.....	44
5.1.	Brezat bioklimatike	44
5.2.	Pyjet dhe kullotat.....	44
5.3.	Tipet e pyjeve	45
5.4.	Tipet e kullotave.....	45
5.5.	Tipet potenciale te vegjetacionit.....	45
5.6.	Biodiversiteti	45
5.7.	Prania e vlerave konservuese të larta (VKL).....	46
5.8.	Rreziqet per biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin.....	46
5.9.	Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor.....	46
6.	Analiza e pyjeve dhe kullotave.....	46
6.1.	Analiza e të dhënave për Pyjet	46
6.1.1.	Analiza e tipeve të pyjeve.....	46
6.1.2.	Shperndarja e siperfaqes dhe volumit sipas formes se qeverisjes	47
6.1.3.	Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit.....	50
6.2.	Analiza e të dhënave të kullotave	51
6.2.1.	Gjëndja e kullotave.....	51
6.2.2.	Madhesia e siperfaqes se kullotave dhe vendodhja e tyre	51
6.2.3.	Altituda, pjerresia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike.....	51
6.2.4.	Mbrritshmëria.....	52
6.2.5.	Grumbullimi i te dhënave per zonat e djegura ne kullota(10 vitet e fundit).....	52
7.	REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	52
7.1.	Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve.....	52
7.1.1.	Analiza statistikore e Inventarizimit.....	52
7.2.2.	Volumi dhe rritja ne volum e grumbujve pyjore	52
7.2.3.	Struktura Vertikale	52
7.2.4.	Cilësia e materialit drusor.....	53
7.2.5.	Biomasa dhe Faktoret e Ekspansionit te Biomases	53
7.2.6.	Analiza e rolit te ekonomise pyjore ne sekuestrimin e karbonit.....	54
7.2.	Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare.....	54
7.2.1.	Drurët e tharë.....	54
7.2.2.	Dëmtimet e tjera	54
7.3.	Prerjet e paligjshme	54
7.3.1.	Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit	54
7.3.2.	Impakti i prerjeve ilegale ne planifikimin dhe mbareshtimin e pyjeve.....	54
7.4.	Rezultatet e Inventarizimit te Kullotave.....	54

7.4.1.	Tipi dhe cilesia e kullotave.....	54
7.4.2.	Perdoruesit e kullotave dhe koha.....	55
7.4.3.	Llojet e bagetive	55
7.4.4.	Perdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtes i kullotave.....	55
7.4.5.	Infrastruktura aktuale	56
7.4.6.	Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorise me baze ushqimore	56
8.	OBJEKTIVAT E MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	56
8.1.	Objektivat e pergjithshme per planifikimin afat-gjate.....	56
8.2.	Objektivat kombetare per Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave Pajtueshmeria e PMPK me planifikimin rajonal dhe ate ne nivel Bashkie.....	56
8.3.	Objektivat kryesore te PMPK.....	58
8.4.	Objektivat specifike te ekonomise pyjore/NJM	58
8.5.	Objektivat specifike mbi perdorimin e tokes, funksionin dhe formen e qeverisjes.....	58
8.5.1.	Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve	58
8.5.2.	Objektivat specifik silvikulturale	59
8.5.3.	Objektivat specifik per kullotat	59
8.5.4.	Objektivat specifik mbi biodiversitetin	59
8.5.5.	Objektivat specifik mbi gjendjen shendetore.....	59
8.5.6.	Objektivat specifik mbi faunen	60
8.5.7.	Objektivat specifik per pyjet me funksion prodhues	60
8.5.8.	Objektivat specifik per pyjet me funksion mbrojtës.....	60
8.5.8.	Objektivat specifik per pyjet me funksion rekreacioni.....	60
8.5.9.	Objektivat specifik per pyjet me funksion konservues.. Error! Bookmark not defined.	
9.	MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NE KUADER TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	61
9.1.	Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit	61
9.2.	Prerja vjetore silvikulturore..... Error! Bookmark not defined.	
9.3.	Planifikimi vjetor i masave.....	64
9.3.1.	Masat ne Pyje	64
9.3.2.	Masat ne kullota	72
9.3.3.	Masat ne infrastrukture dhe ne zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike	72
9.4.	Masat afat-gjata	73
9.4.1.	Masat silvikulturale ne trungshte	73
9.4.2.	Masat silvikulturore ne cungishte.....	77
9.4.3.	Masat silvikulturore ne shkurre	78
9.4.4.	Pyllëzimi, ripyllëzimi	79

9.4.5.	Masat në kullota	80
9.4.6.	Gjendja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore.....	80
9.4.7.	Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike.....	83
10.	VLERËSIMI EKONOMIK.....	83
10.1.	Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota	83
10.2.	Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve.....	84
10.3.	Planifikimi i kostove/shpenzimeve.....	85
10.4.	Analiza kosto-përfitim.....	86
11.	LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE SISP	86
12.	PROÇESI I VALIDIMIT TË PMPK NË SISP	86
13.	MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE	87
14.	MONITORIMI I ZBATIMIT TE PMPK.....	87
15.	RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT.....	87
16.	RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TE MBARESHTRIMIT	87
17.	RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT	88
18.	PËRGATITJA E HARTAVE.....	88
19.	PLANI 10 VJEÇAR I PUNIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS KATEGORIVE TË PUNIMEVE	Error! Bookmark not defined.
	PJESA E DYTË (Përshkrimi parcelar).....	90
20.	Lista e ngastrave, n/ngastrave me të dhënat kryesore	90
21.	Lista e nëngastrave në rend numerik dhe analfabetik.....	104
21.	Udhëzuesi për përshkrimin parcelar.....	110
	PJESA E TRETË.....	111
22.	INVENTARIZIMI.....	111
22.1.	Rezultatet e sipërfaqeve provë	111
22.2	Sipërfaqet provë të renditura sipas ngastrave	124
15.3	Analiza statistikore	Error! Bookmark not defined.
15.4	Formularët e terrenit.....	129
15.6	Harta me rrjetin e sipërfaqeve provë	129
15.7	Udhëzuesi për inventarizimin me sipërfaqe provë	129

PJESA E PARË

1. HYRJE

1.1. Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe Kullotave, (PMPK)

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjorë. Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar “sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve”. Gjithashtu, ky plan menaxhimi duhet të garantojë përdorim racional të burimeve natyrore pyjore dhe kullimore, si dhe të kontribuojë në cilësinë e jetesës në zonën rurale.

Objektivat e projektit të ri janë prezantuar tek të gjithë aktorët, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore.

Objektivate planit të mbarështimit u hartuan në mbështetje të ligjit për zhvillimin e sektorit pyjor, ligji kuadër 57/2020 “Për pyjet” dhe në bashkëpunim me shërbimin pyjor të bashkisë, popullatën dhe organet e pushtetit vendor. Objektivat kryesore janë:

Objektivat specifike të planit të mbarështimit do të jenë:

- ✓ Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve prodhuese në pyje dhe qëndrueshmëria e tyre .
- ✓ Sigurimi i rritjes së masës dhe cilësisë drusore në grumbujt pyjorë dhe produkteve të tjera pyjore jo drusore në përputhshmëri me nevojat lokale.
- ✓ Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor;
- ✓ Sigurimi i rritjes së qëndrueshmërisë të grumbullit pyjorë përmes teknikave silvikulturale, dhe pyllëzimeve;
- ✓ Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungsishtëve me funksion prodhues;
- ✓ Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit;
- ✓ Mbrojtja e ekosistemeve natyrore dhe biodiversitetit në pyje.
- ✓ Perforcimi i ekosistemeve pyjore si habitate për speciet e egra dhe mbrojtja e specieve të rrezikuara.
- ✓ Parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e cilësisë së ujit duke marrë masa në disiplinimin e regjimit hidrologjik.
- ✓ Rehabilitimi i sipërfaqeve të demtuara dhe krijimi i grumbullit me rritje të qëndrueshme.
- ✓ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marrjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullimore me interesat e përdoruesve.

1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Etapat e punës në hartimin e planit të mbarështimit kanë qënë:

1-Etapa përgatitore e cila ka të bëjë me: (i) grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e planit të mbarështimit si: plani inventarizimit, studime të tokave dhe vegjetacionit, të dhëna të kadastrës pyjore etj; (ii) hartat pyjore (ndarja parcelare, nenparcelare dhe vendosja e rrjetit të sipërfaqeve prove në hartën pyjore).

2- Etapa e matjeve të terrenit: Kjo fazë shërben për të siguruar të dhënat bazë për vlerësimin e burimeve pyjore dhe kullosore që do sigurohen nga përshkrimi parcelar dhe nga inventarizimi. Kjo fazë përfshin:

- **Përshkrimin parcelar dhe nën parcelar-** përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme për të siguruar një pamje të plote të gjendjes aktuale të burimeve pyjore sipas ngastrave duke përcaktuar edhe masat e nevojshme.
- **Inventarizimi-** nënkupton matjet në nivel sipërfaqe prove Brenda ngastrave pyjore me qëllim llogaritjen e treguesve dendro-auksometrikë në nivel ngastrave pyjore.

3- Etapa e punës në zyrë: Përfshin përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e draftit të Planit të Mbarështimit. Në këtë etapë përcaktohen objektivat e planifikimit dhe masat lidhur me menaxhimin multifunksional funksional të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë Gomsiqe.

1.3. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës është bazuar në Manualin e mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të miratuar nga MTM me shkresën nr.864 prot date 30.01.2019.

Punimet përgatitore u kryen para fillimit të punës në terren dhe kanë patur si qëllim sigurimin e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm për hartimin e planit të mbarështimit.

Materialet e nevojshme për hartimin e planit të mbarështimit të siguruara ishin: hartat topografike me shkallë 1: 25000 dhe harta e ndarjes parcelare të ekonomisë pyjore Gomsiqe, ortofotot nga ASIG të vitit 2015, të dhënat e planit të vjetër të inventarizimit, studimet pedologjike, gjeologjike etj. Nëpërmjet hartave dhe ortofotove u bë e mundur shënimi i kufijve të ngastrave pyjore dhe më pas u bë materializimi i kufijve në terren duke përdorur shenja të dukshme në përputhje me ato të përshkruara në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve. Po kështu u realizua rikonjicioni në terren për të identifikuar kufijtë e ngastrave dhe shtrirjen e kësaj ekonomie për të cilën do të hartohet plani i mbarështimit.

Metodologjia e ndjekur në inventarizimin e grumbujve ka qënë nëpërmjet sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme. Sipërfaqet prove, megjithatë masin vetëm një pjesë të vogël të pyllit, lejojnë nxjerrjen e shpejtë dhe të besueshme të konkluzioneve për të gjithë ngastrën pyjore. Rezultatet e marra janë të besueshme dhe mbartin vetëm disa gabime të rastësishme, për sa kohë që sipërfaqet prove janë zgjedhur mbi parime strikte statistikore.

Për vendosjen e sipërfaqeve provë dhe për punimet e terrenit u përdoren:

- Hartat topografike me shkallë 1:25 000
- ortofotot e ASIG të vitit 2015 dhe imazhet satelitore

Sipërfaqja minimale e një nëngastre është 0.5 ha dhe në hartat me shkallë 1:10 000 identifikimi i tyre është më i lehtë. Hartat pyjore dhe ato topografike u dixhitalizuan dhe më pas u përdoren në formatin 1:10 000 për të lehtësuar përcaktimin e saktë të kufijve të ngastrave dhe nëngastrave pyjore. Gjeoreferimi u krye duke përdorur hartat e vjetra pyjore të kësaj ekonomie pyjore. Pas përcaktimit të saktë të kufijve në hartë dhe verifikimit në terren, puna vazhdoi me ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve provë. Bazuar në hartën digjitale u gjetën koordinatat gjeografike të qendrave të sipërfaqeve provë të cilat u regjistruan në GPS Garmin 64 dhe më pas puna vazhdoi me vendosjen në terren të sipërfaqeve provë dhe kryerjen e matjeve.

Inventarizimi i ekonomisë pyjore Gomsiqe u realizua nëpërmjet metodës së kampionimit me sipërfaqe prove të vendosura në mënyrë sistematike. Vendosja e sipërfaqeve prove u krye në baze të rrjetit kilometrik 1000 x 1000 m të hartave pyjore të digjitalizuara. Metodologjia e ndjekur për ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve prove jepet me poshte:

1. Rrjeti kilometrik i hartave topografike (1000 x 1000 m) sipas sistemit koordinativ UTM, është rrjeti baze reference për ndërtimin e rrjetit sistematik të sipërfaqeve prove të vendosura në interval uniforme.
2. Rrjeti i sipërfaqeve prove u orientua sipas drejtimit Veri/Jug dhe Lindje/Perendim
3. Rrjeti kilometrik u dendësua duke u ndarë në interval uniforme. Në këtë mënyrë sipërfaqet prove të perhershme u vendosën sipas rrjetit 200 x 200 m (intensiteti i kampionimit 1 sipërfaqe prove në 4 ha). Në një kuadrat të rrjetit kilometrik u formuan 25 njësi katrore me madhësi 200 x 200 m.
4. Për një nivel saktësie më të lartë, rrjeti i mesiperm u dendësua edhe me shumë çdo 100 m ose 50 m. Në këtë mënyrë në rrjetin e dytë të sipërfaqeve prove 100 x 100 m (1 sipërfaqe prove për 1 ha) ose 50 x 50 m (1 sipërfaqe prove për 0.25 ha) u vendosën sipërfaqet e përkohshme.

Numri i sipërfaqeve prove u llogarit përpara se të filloje puna në terren. Përkete qëllim sipërfaqja e ekonomisë pyjore u nda fillimisht sipas formës së qeverisjes:

Më pas secila formë qeverisjeje u nda në njësi më homogjene sipas: (i) tipit të pyllit ose (ii) klases së moshës.

Llogaritja e numrit të sipërfaqeve prove u bë sipas ekuacionit të mëposhtem:

$$N=\{(CV *T)/E\}^2$$

CV— koeficienti i variacionit=±30% - 65%, për nën shtresën klasë moshe/tipi i grumbullit si shtresë më e ulët.

P—probabiliteti =95%

T—shkalla e lirise (kur P=95%, T=1.96(≈2)) lidhet me probabilitetin e vendosur me sipër

E—gabimi standart i lejuar (shih objektivat për shtresat dhe nënshtresat) N— numri i sipërfaqeve prove.

Metoda e përdorur për llogaritjen e gabimit bazohet në analizen e variancës duke përdorur diferencën e vrojtimeve në sipërfaqet prove të perhershme të cilat janë të njëjta njësi prove në të 2 inventarizimet e njëpasnjëshme. Treguesit statistikore që u përdorën për llogaritjen e numrit të sipërfaqeve prove sipas formës së qeverisjes, tipit të pyllit dhe klases së moshës jepen në Tabelën 1.

Tabela 1. Treguesit statistikore per llogaritjen e numrit te siperfaqeve prove sipas formes se qeverisjes, tipit te pyllit dhe klases se moshes.

Forma e qeverisjes	Kriteret	Shtresa/ nenshtresa	Gabimi standart ($\Delta_{\%}$)	Madhesia e sip prove	Kufiri i Diambazimetri k	Shenime
Trungishte	- Volumi -Nr drurve - Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshes	< 10% <20%	(400 m ²)	> 27.5 cm	Per filizerine me d < 2 cm do behet vetem numerimi
				(200 m ²)	7.5-27.5 cm	
				(25 m ²)	2-7.5 cm	
Cungishte	- Volumi -Nr drurve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshes	< 10%	(400 m ²)	> 27.5 cm	Nuk do matet as azimuti as distanca
				(200 m ²)	7.5-27.5 cm	
				(25 m ²)	2-7.5 cm	
Trungishte e perbere	- Volumi -Nr drurve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshes	T < 20% C < 10%	(400 m ²)	> 27.5 cm	Nuk do matet as azimuti as distanca
				(200 m ²)	7.5-27.5 cm	
				(25 m ²)	2-7.5 cm	
Cungishte e perbere	- Volumi -Nr drurve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshes	C < 10% T < 30%	(400 m ²)	> 27.5 cm	Nuk do matet as azimuti as distanca
				(200 m ²)	7.5-27.5 cm	
					2-7.5 cm	

				(25 m ²)		
Kullota	-Siperfaqja -Mbulesa e vegjetacionit	-kullota -kullota me drure dhe shkurre	10-20% siperfaqes	25 m ²	asnje	Informacion i detajuar persiperfaqen kullosore
Shkurre	-Siperfaqja -Numri individeve -Specia	shkurret	10-20% siperfaqes	25 m ²	asnje	Informacion i pergjithshem per grumbullin - lartesia dominante dhe mesatare -mosha

Numri minimal I siperfaqeve prove sipas siperfaqes se grumbullit pyjor duhet te jete:

Tabela2. Numri minimal i sipërfaqeve prove sipas sipërfaqes së parcelave pyjore

Siperfaqja e grumbullit pyjor (ha)	< 4 ha	4-10 ha	> 10 ha
Numri minimal I siperfaqeve prove	5 siperfaqe prove	7 siperfaqe prove	10 siperfaqe prove

Nga llogaritjet sipas ekuacionit të mësipërm rezultoi se numri i nevojshëm i sipërfaqeve provë është 784 siperfaqe prove te perhershme

$$n = \frac{t^2 \cdot S_x^2}{e^2} = \frac{2^2 \cdot 70^2}{5^2} = 784$$

Siperfaqet prove të përdorura jane rrethore me madhësi 200 m² (r = 7.98 m), për trungishtet me moshë nën 60 vjeç dhe për cungishtet,kurse për shkurret u përdorën sipërfaqe provë me madhësi 25 m². Në varësi të pjerrësisë së terreni u bë edhe korigjimi i rezes së sipërfaqeve provë duek iu referuar tabelës së mëposhtme:

Tabela 3. Korigjimi i rrezes se sipërfaqeve prove sipas pjerrësisë

Pjerrësia (%)	Pjerrësia (grade)	Rrezja (m) 400 m²	Rrezja (m) 200 m²	Rrezja (m) 25 m²		Pjerrësia (%)	Pjerrësia (grade)	Rrezja (m) 400 m²	Rrezja (m) 200 m²	Rrezja (m) 25 m²
0-10	0.0	11.28	7.98	2.82		80	38.7	12.77	9.03	3:19
15	8.5	11.35	8.02	2.84		85	40.4	12.93	9.14	3:23
20	11.3	11.39	8.06	2.85		90	42.0	13.09	9.25	3:27
25	14.0	11.46	8.10	2.86		95	43.5	13.25	9.37	3:31
30	16.7	11.53	8.15	2.88		100	45.0	13.42	9.49	3:35
35	19.3	11.61	8.21	2.90		105	46.4	13.59	9.61	3:40
40	21.8	11.71	8.28	2.93		110	47.7	13.76	9.73	3:44
45	24.2	11.82	8.36	2.95		115	49.0	13.93	9.85	3:48
50	26.6	11.93	8.44	2.98		120	50.2	14.10	9.97	3:53
55	28.8	12.05	8.52	3.01		125	51.3	14.28	10.09	3:57
60	31.0	12.19	8.62	3.05		130	52.4	14.45	10.22	3:61
65	33.0	12.32	8.71	3:08		135	53.5	14.63	10.34	3:66
70	35.0	12.47	8.82	3:12		140	54.5	14.80	10.47	3:70
75	36.9	12.62	8.92	3:15		145	55.4	14.98	10.59	3:74

Kordinatat e sipërfaqeve prove u regjistruan në GPS dhe më pas u realizua vendosja e tyre në terren. Pozicionimi i sipërfaqeve prove u bë me një gabim minimal. Për këtë arsye të paktën 5 satelitet duhet që të jenë të lidhur me GPS për të vendosur saktësisht qendrën e sipërfaqes prove. Krahas GPS u përdor edhe busulla për të përcaktuar saktësisht drejtimin dhe për të gjetur pozicionin e saktë të qendrës së sipërfaqes prove brenda grumbullit pyjor.

Shënimi i qendrës së sipërfaqes prove të përhershme u krye me një gozhdë me gjatësi 20-25 cm dhe diametër 3 cm e cila u ngul në tokë derisa pjesa e sipërme të ishte rrafsh me tokën. Për secilën qendër sipërfaqe prove u vendosën 3 pika referimi sa më afër qendrës. Për secilën pikë referimi, distanca dhe azimuti i pikës fikse nga qendra e sipërfaqes prove u matën. Në rastin e sipërfaqeve prove të perkohshme qendra nuk u shënuar me gozhdë dhe nuk u morr asnjë pikë referimi. Brenda sipërfaqeve provë u ndoq kjo procedurë matjeje:

a-njeri nga specialistet e grupit të punës u vendos në qendër të sipërfaqes prove dhe me busull përcaktoi drejtimin e Veriut magnetik

b-druri i parë nga filloi matja ishte ai me afër veriut ose që kishte këndin azimutal më të vogël

c-specialisti tjetër identifikonte specien dhe më pas u mat diametri bazimetrik i drurëve (1.3 m nga toka) sipas 2 drejtimeve. Në matjen e parë të diametrit bazimetrik të drurit, vizorja e kalibrit drejtohej

per nga qendra e siperfaqes prove, kurse matja e dyte u krye ne nje kend 90° me pozicionin e pare. Diametri bazimetrik i drurit u llogarit si mesatare arithmetike e 2 diametrave bazimetrike te matur.




Figure 1. Matja e diametrave të drurëve brenda sipërfaqeve provë

Azimuti I drurit matet duke shikuar anen e majte te trungut, ne lartesine e gjoksit. Distanca midis qendres se siperfaqes dhe mesit te drurit matet paralelisht me shpatin e pjerret ne decimetra, gjithashtu ne lartesine e kraharorit. Atje ku druret jane ne skaj diametric matet me diametermates ne lartesine e kraharorit rezultati pergysmohet dhe matet distance prej kesaj vlere mesataren e shkallen e diametermatesit dhe qendres se siperfaqes. Ne qoftese distance eshte me madhe se rrezja e siperfaqes, druri nuk shenohet (poshte majtas); kur distance eshte me e vogel atehere druri perfshihet ne siperfaqe prove (poshte djathtas).

Matja e diamentit bazimetrik është bërë me saktësi ± 1 cm duke filluar nga:

- ≥ 10 cm per trungishtet ($10.1 = 10$ cm)
- ≥ 6 cm për cungishtet ($6.1 = 6$ cm)

Në rastin e pyjeve të përbërë u përdorën këto vlera limit:

- Trungishte e përbërë (pyll i lartë) ≥ 10 cm
- Cungishte e përbërë (cungishte) ≥ 6 cm

Matja e lartësisë

Matja e lartësisë së drurëve Brenda sipërfaqeve provë u krye me Vertex me ultratingull me transponder. Në secilën sipërfaqe provë u matën 3 lartësi për secilën kategori diametrike. Lartësia mesatare është llogaritur me formulën Lorej duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

$$h_g = \frac{g_1 \cdot h_1 + g_2 \cdot h_2 + \dots + g_n \cdot h_n}{g_1 + g_2 + \dots + g_n}$$

ku: h_g -lartësia e drurit mesatar te siperfaqes bazimetrike; g_i -siperfaqja bazimetrike e kategorise diametrike (m^2); h_i -lartësia mesatare e kategorise diametrike (m).

Llogaritja e volumit për secilën ngastër sipas specieve është bërë nëpërmjet programit në Access për Planet e Mbarështimit.

1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

Në hartimin e planit të Mbarështimit janë përdorur burimet e mëposhtme të informacionit:

- plani i inventarizimit i ekonomisë pyjore Gomsiqe 1985
- studime apo botime për tokat, klimën dhe vegjetacionin në zonën e Pukes
- foto ajrore dhe imazhe satelitore të fundit të zonës
- harta topografike ushtarake me shkallë 1: 25000
- informacioni nga rikunjicioni i terrenit

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË PYJORE

2.1 Informacioni përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore

Ekonomia pyjore e Gomsiqe shtrihet në

territorin e bashkisë Puke dhe aktualisht administrohet nga bashki, dikur administrohej nga DSHP Pukë. Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore Gomsiqe është **8766.4 ha**. Plani

I mbarështimit është I vlefshëm për periudhën kohore nga 2025 deri 2035. Ekonomia pyjore është me të njëjtin emër dhe ka patur një sipërfaqje totale prej 8577.8 ha, ndërsa me planin e ri, kjo sipërfaqje është **8766.4 ha**.

Përshkrimi I përgjithshëm I ekonomisë ka për qëllim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale të mprehta të zones ku do të kryhet mbarështimi, në mënyrë që të gjejnë pasqyrim në objektivat e mbarështimit për të ardhmen.

2.2. Pronësia, administrimi dhe organizimi

Pyjet kane luajtur një role mjaftë të rëndësishme në menyrën e jetesës së banorëve të zones duke qenë zona malore me klimë të ashpër dhe terren të thyer ku sipërfaqjet bujqesore janë të pakta dhe me prodhimtari të ulët, banorët për shkak kanë përdorur sipërfaqjet pyjore si burim jetese kryesisht për ushqime për blektorinë, ajo që vlen të përmendet është se banorët në moshe të vjetër konsiderojnë pyjet si pronë të tyre dhe shprehen para se vinte në qeverisje partia komuniste pyjet njiheshin si pronë private e familjeve që jetonin në fshatra dhe ishin të ndara me kufi si dhe ekzistonte dhe shitblerja e tyre.

Ndërsa sot pyjet dhe kullotat pjesë e ekonomisë pyjore Gomsiqe janë të gjitha në pronësi të bashkisë të transferuar me Vendimin Këshillit të Ministrave Nr 433 datë 08.06.2016. Pra, me këtë veprim, e drejta e pronësisë është transferuar nga qeverisja qendrore në atë vendore, e cila do t'u japë ato në përdorim banorëve të fshatrave të saj. Nga dhënia e pyjeve në përdorim të komuniteteve, do të

garantohet ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve dhe kullotave. Kështu që roli kryesor për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave do t'u kalojë banorëve vendas, ndërsa personeli pyjor do të ketë rolin këshillimor dhe kontrollues.

Ekonomia pyjore Gomsiqe përbëhet nga 11 fshatra dhe koncretisht: Kaftall, Vrrith, Korrrhpule, Gomsiqe, Dush, Karme, Kcire, Qarret i Madh, Puke fshat, Pla, Luf, Plet

Në ekonomi ekzistojnë të drejtat e përdorimit si më poshtë:

- ✓ E drejta e përdorimit për kullotje.
- ✓ E drejta e përdorimit për grumbullim bazë ushqimore për blegtorinë, për dimrit
- ✓ E drejta e përdorimit për të prodhuar dru zjarri dhe lëndë drusore për ndërtim.

Në të gjitha rastet këto të drejta përdorimi u përkasin banorëve të kësaj krahine. Përsa i takon problemeve të pronësisë si për kullotat ashtu edhe për pyllin nuk ekzistojnë konflikte ndërmjet banorëve vendas, ka një ndarje pakashume të stabilizuar midis pronësisë publike dhe asaj private. Sipërfaqja e pyjeve për prodhim gjethi është ndarë në bazë fisesh (familjesh) edhe pse kjo nuk ka bazë ligjore dhe nuk është bërë nga shërbimi pyjor.

2.2 Pronësia, administrimi, organizimi

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, Bashkisë Puke nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 433, datë 8.6.2016, Fletorja zyrtare Nr 110 "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te Pyjeve dhe Kullotave Publike, sipas listes se inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te Ish-Komunave/Bashkive, shtojca 48, i ka kaluar në pronësi fondi pyjor prej 8577.8ha që ka kjo ekonomia pyjore Gomsiqe. Në pasqyrën e mëposhtëme, jepen të dhënat e ekonomisë pyjore sipas formës së përdorimit të teritorit të sipërfaqes që zënë sipas zërave:

Tabela 1. Sipërfaqja sipas përdorimit të teritorit në ekonominë pyjore GOMSIQE

Përdorimi teritorit	Sipas planit vitit 1985	2025
Pyll	5270	4700.2
Sip Inproduktive (shkembore)	298.8	643.8
Toke Bujqësore	1673	1847.5
Kullote/livadh	617	815.0
Urban	159	159.1
Toke me bimesa pyjore	453	477.2
Sip Djerr	105	123.7
TOTALI	8577	8766.4

2.3. Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore Gomsiqe formohet nga bazent e lumit të gomsiqes dhe perroit të Arrcanit që derdhet në Gomsiqe në anën perëndimore të ekonomisë. E gjithë ekonomia përbëhet nga 2 mikrobazene që formojnë një të vetëm. Emrin e ka marrë pikërisht nga lumi i Gomsiqes që e prshkon në gjithë gjatësinë e sajë

Kufizimet e ekonomise Pyjore Gomsiqe Jane

V-Kufizohet nga Ekonomia Pyjore Dedaj-Buhot,dhe Ekonomia PyjoreQelez.

J-Kufizohet me Pyjet e Bashkise Lezhe dhe ato te Bashkise Vau-Dejes

L-Kufizohet nga Ekonomia Pyjore Terbun .

Ekonomia përfshihet në hartat me shkallë 1: 25000 ;

është nën juridiksionin Njesise Administrative Qerrette Bashkisë Pukë dhe shtrihet në Jug-perëndim të kësaj bashkie. Kjo njësi administrative ka një shtrirje mjaft të gjerë territoriale,qendra e njesise Administrative dhe ndodhet 8 km në jug-perëndim të Pukës. Ekonomia pyjore Gomsiqe shtrihet midis gjatësive gjeografike 19° 54' 12." deri 19° 44' 00" dhe gjerësitë gjeografike 41° 56' 48"deri 42° 00' 24"

Pika më e ulët është te perroji i kaftalles 190 m mbi nivelin e detit, e deri në lartësinë 980 m në Qaf bater.

Ekonomiapyjore			Largësia e ekonomisë (km) nga
Skaji më i largët	Qendra	Skaji më afërt	Qendra e rrethit
Prroi i Vrrithit	Gomsiqe	Qarreti	0

Kufijtë natyrore të ekonomisë pyjore Gomsiqe janë:

Orientimi	Kufizuesit e ekonomise pyjore Gomsiqe	Kufijtë natyrorë të ekonomisë (kurrize, kulme, qafa, rrugë auto, përrenj, lumenj, etj)
Veri	Ekonomia pyjore Dedaj-Buhot	Kurora e Puke nga Laxhia Zezaj vazhdon ne fundin e fushes se eger kodra e buces,Jermen,kufiri i qarretit te vogel deri te Boka e Katundit,Qarret i Madh
Jug	Fshatrat e Bashkise Lezhe	Përroi I FshatitVrrith ne pjesen jug-lindoredhe me fshatin Mnel te bashkiseVau-Dejes deri ne

		qafe qele ne pjesen Jug-lindje
Lindje	Ekonomia pyjore Terbun	Maja e ArcanitPodi I Qershise, vazhdon ne perroin e Arcanit dhe zbret ne Lumin e Gomines nxhitet ne buzith,maja e pshtymes deri ne fshatinVrrith
Perëndim	Ekonomia pyjore Dush	Ne pjesen perendimore me malet e Qerreti ,rrasa e Qerretit,Maja e Sertokut,maja e dresllit,deri ne kodrat e Vrobtines shpati I Ferthit zbret deri ne lumin e Gomsiqes.

2.4. Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Në territorin e Bashkisë Puke, Pyjet dhe kullotat, menaxhohen respektivisht në disa ekonomi pyjore, njëra prej të cilave është edhe ekonomia pyjore Gomsiqe .Për këto ekonomi pyjore janë duke u hartuar Planet e Mbarështimit të pyjeve e kullotave.

Plani i Mbarështimit nga përpunimi i të dhënave të marra në terren jep një tablo të qartë të gjëndjes dhe konsistencës së pyjeve përmes spërfaqes, tipit të grumbujve pyjorë dhe të përdorimit të territorit dhe veçanërisht të strukturës së pronësisë.

Grupet e punës gjatë gjithë kohës ishin në kontakt me komunitetin që banon dhe kryen veprimtarinë e tij lidhur me pyllin dhe mjedisin pyjor, duke i përfshirë ata në diskutim dhe planifikim dhe vendimarrje , për të realizuar menaxhimin me pjesëmarrje të komunitetit.

Ekonomia pyjore ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 8766.4ha dhe sipas përdorimit të territorit ka këtë strukturë :

Tab.4.2

Nr	Emërtimi	Sipërfaqja (ha) viti 2025
1	Pyje	4700.2
2	Kullota-livadhe	815
3	Sip.me bimësi pyjore	477.2

4	Sipërfaqe djerr,e boshe	123.7
5	Sipërfaqe joproductive,	643.8
6	Sipërfaqe ujore	0
7	Sipërfaqe urbane	159.1
8	Sipërfaqe bujqësore	1847.5
	Shuma	8766.4

Pyjet me funksion prodhues zënë një sipërfaqje si më poshtë në tabelën.

Nr	Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	%
1	Pyjetrungshte	1677.73	37.5
2	Pyje cungishte	1500.08	33.1
3	Trung+Cung	483.1	9.9
	Cung, trung	357.0	7.3
	Shkurre	682.1	12.1
	Totali	4700	100

Për përmirësimin e vazhdueshëm të gjëndjes së pyjeve janë propozuar masa konkrete në drejtim të: rritjes së prodhimit të grumbujve pyjorë, përdorimit optimal të stacionit, sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore dhe artificiale, ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës, mbrojtjes së pyjeve nga zjarret dhe prerjet paligjshme, rehabilitimit të infrastrukurës rrugore, krijimit të tregut të punës dhe më kryesorja për

Fshirja e popullatës lokale në vendimmarrjet kryesore për mbarështrim të qëndrueshëm të ekonomisë pyjore.

.

Punimet e terrenit filluan në përputhje me grafikun e hartuar për këtë qëllim dhe për përfundimin në kohë të tyre u angazhua grupi I punës në përbërjen e të cilit merrnin pjesë 2 inxhinier pyjesh dhe dy teknike 1

Agronom dhe një specialist GIS-si. vlen për të theksuar se plani i mbarshtimit të ekonomisë pyjore Gomsiqe është hartuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave me burimet njerzore dhe mjete që disponon. Pajisjet e përdorura nga grupi i punës në teren për kryerjen e rievime janë modeste; GPS, vertex, tablet, hipsometër Blume-leiss, busulla, tryela Pressler, diametramatës, metërshirit, rrjeti i sipërfaqes me koordinatat përkatëse dhe harta në format A3, etj.

2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore

Kjo ekonomi pyjore e ka marrë emrin nga Lumi i Gomsiqes i cili e kalon përmes ekonomisë . Në vitin 1985 është hartuar plani i Inventarizimit nga stafi i Ndërmarrjes Pyjore Pukë . Deri në vitin 2009 kjo ekonomi pyjore ka qënë administruar nga Ish Drejtoria e Shërbimit Pyjor Pukë dhe më pas deri në vitin 2015 nga Komuna Luf-Qarret. Pas vitit 2015, me kryerjen e reformës administrative kompetencat e administrimit dhe pronësia e kësaj ekonomie pyjore kaloi tek Bashkia Pukë. Duhet theksuar se mungesa e planit të mbarështimit ka penguar zbatimin e punimeve të nevojshme në këtë ekonomi dhe masat e propozuara nga ky plan mbarështimi do të ndikojnë në përmirsimin e gjëndjes së burimeve pyjore të kësaj ekonomie.

2.6. Situata demografike dhe social ekonomike

Popullsia vendore në këtë ekonomi është në një gjëndje social-ekonomike jo të kënaqëshme edhe pse kanë aq afër pyje e kullota.

Pylli, aktualisht është një burim jetese për popullsinë që jeton në brëndësi dhe në afërsi të ekonomisë. Dëmtime kanë pësuar pyjet e kësaj ekonomie sidomos në periudhën e zgjatur të tranzicionit. Sasia e lëndës drusore, që është prerë nga vendasit është përdorur për nevojat e tyre. Ajo e ka përmirësuar gjërat në një farëmasë aspektin social-ekonomik të banorëve vendas por nuk e ka zgjidhur problemin e varfërisë.

Pra si konkluzion mund të themi se të ardhurat e banorëve, që aktualisht banojnë në këto fshatra mbeten në nivele të ultederi mesatare. Shtimi i të ardhurave të tyre mund të bëhet vetëm me investime të mundshme në përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale si edhe në sektorin e pyjeve dhe turizmit.

Të dhëna demografike dhe të tokës bujqësore

Nr	Fshati	Familje	Banorë			Tokëbujqësore (ha)
			Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
1	Kaftall	45	217	107	110	190
2	Korrthpule	73	320	171	149	320
3	Vrrith	22	89	43	46	78

4	Gomsiqe	27	96	51	45	82
5	Dush	17	56	25	31	18
6	Karme	15	42	25	17	15
7	Kcire	141	462	230	232	335
8	Pleti	42	216	112	104	98
9	Luf	65	267	134	133	83
10	Pla	72	303	155	148	86
11	Qarretimadh	120	530	271	259	512
12	Fshati Puke	215	846	416	430	86
	Totali	854	3441	1740	1704	1820

Numri i femrave dhe meshkujve është respektivisht 1740 dhe 1740, ndërsa raporti ndërmjet tyre është 50.5 % me 49.5 %. Nga numri total i popullsisë, 3441 banorë, dhe 60 % e numrit total, janë mbi 60 vjec.

Referuar të dhënave mbi token bujqesore duhet theksuar se një pjesë e konsiderushme e sipërfaqjes janë toka të hapura nga ish kooperativat të cilat kategorive të prodhimtarisë mbi 8 qe është toka me prodhimtari të ulët dhe për pasojë një pjesë janë të abondonuara.

Të dhëna mbi blegtorinë

Në fshtrat e Njesisë Administrative Qerret që janë ekonomisë pyjore Gomsiqe, banorët mbarështojnë gjithsej 1800 krerë, nga të cilat 1300 krerë dhi, 150 krerë dhen, 350 krerë lopë .

Nr.	Fshtrat	Të dhëna për blegtorinë				Prodhi (Kv)
		Dhen	Dhi	Gjedhë	Qumësht	Mish
1	Kaftall	0	100	10	150	110
2	Korrthpule	100	300	30	520	600
3	Vrrith	0	200	20	250	420
4	Gomsiqe	0	150	30	250	450
5	Dush	0	250	10	200	350

6	Karme	0	0	15	110	150
7	Kcire	20	50	40	200	450
8	Pleti	0	20	20	150	220
9	Luf	0	80	35	170	320
10	Pla	0	40	20	120	240
11	Qarretimadh	30	60	70	400	800
12	Fshati Puke	20	50	40	250	470
	Totali	150	1300	350	2770	4580

Nga të dhënat emesiperme rezulton se në këto fshatra mbarështohen një numër i konsiderueshëm krerë bagëtish që bazën ushqimore e kanë edhe në ekonominë pyjore Gomsiqe. Kullotat përdoren nga blegtorët gjatë gjithë vitit megjithëse janë të pakta, po ashtu ata përdorin edhe pyjet me shkurre rreth fashatrave për kullotë.

Kjo mënyrë mbarshtimi e blegtorisë nuk është vetëm për motive të traditës, por detyrohet edhe nga mungesa e tokës bujqësore për kultivimin e foragjerëve. Produktet blegtorale tregtohen kryesisht në Puke dhe Shkoder.

2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore

Nxitja e grumbullimit dhe kultivimit të bimëve mjekësore sidhe gjetja e tregut sigurisht do të mund të ndihmonin në shtimin e të ardhuravemëtë mira. Nga kompanitë grumbulluese të prodhimeve jo drusore pyjore duhet të investohet në drejtim të trainimit të punëtorëve grumbullues për mënyrën dhe teknikën e vjeljes së produkteve pyjore jo drusore, pasi një investim i tillë është në të mirën e menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe vazhdimësisë së prodhimit.

Tab.3 Të dhënat mbi bimët e ndryshme që grumbullohen

Nr	Llojet	Sasia që prodhohet (kg)	Sasia që grumbullohet (kg)	Çmimi (leke/ kg)	Shuma (lekë)
1	Manaferra	1500	1000	80	80000
2	Dredheza	800	600	700	420000
3	Trëndafiliegër	1100	0	100	0
4	Lisna	1500	0	0	0

5	Kerpudhra	4000	3500	400	1400000
6	Hithër	1200	0	100	10000
7	Dellinja e kuqe	1500	500	80	40000
TOTALI		11600	5600		1950000

2.8.Gjuetia dhe peshkimi

Përgjithësisht fauna ka pësuar dëme të shumta, për shkak të prishjes së habitateve dhe ushtrimit të gjuetisë pa kriter. Po ashtu gjatë njëperiudhe mbi 25 vjeçare nuk janë kryer shërbime në dobi të shtimit të faunës së egër.

Nga informacionet e grumbulluara, nëpërmjet intervistave të ndryshme dhe disa vëzhgimeve, konstatohet se në territorin e pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe, gjenden lloje të ndryshëm kafshësh dhe shpendësh të egër. Ndër llojet më të rëndësishëm, por që hasen rrallë janë: Ujku, thëllëza, pëllumbi i egër . Llojet që takohen zakonisht janë dhelpra, lepuri, laraska, grifsha dhe mëllenja. Aktualisht situata me pyjet ka filluar të përmirësohet, e për pasojë edhe fauna e egër nuk është shumë e kërcënuar. Një ndihmesë të padiskutueshme në shtimin dhe përmirësimin e situatës së faunës së egër ka moratoriumi i gjuetisë. Megjithatë është e nevojshme të merren masa, për një kontroll gjithnjë e më të rreptë të aktivitetit të gjuetisë ilegale me mjete çfarosëse të faunës së egër.

Natyra dhe pejsazhet e bukura e me vlera të spikatura, që ka zona e kombinuar kjo edhe florën e faunën e pasur e bëjnë ekonominë pyjore një zonë që në të ardhmen mund të zhvillohet krahas turizmit edhe gjuetia e organizuar turistike e cila mund të shndërrohet në një burim të ardhurash të mira për popullsinë lokale.

2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike

Në territorin e ekonomisë pyjore Gomsiqe ka disa struktura të tipit agrobiznesi të cilat janë akoma në fazat e para të zhvillimit të turizmit. Deri më tani nuk ka ndonjë guide turistike për ecjet në terrene malore apo gara me biçikleta, gjithashtu nuk ekziston asnjë skicë apo hartë me shtigjet dhe rrugicat për këmbësorët. Në këtë zonë mund të krijohen shumë mundësitë për zhvillimin e turizmit natyror duke shtuar shtëpitë e pritjes për turistët vendas dhe të huaj.

Zhvillimi i turizmit natyror në pyjet dhe fshatrat e zonës afër rezervuareve të ujit dhe pyjeve me pisha, është një mundësi punësimi për banorët e zonës si dhe përdorimi i vlerave të burimeve natyrore.

Deri tani nuk ka të dhëna për numrin e turistëve as për të punësuarit në këtë fushë të aktivitetit njerzor. Vizitorët e zonës janë më së shumti njerëz që shfrytëzojnë lidhjet e tyre shoqërore dhe miqësore dhe akoma nuk quhen turist.

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

3.1. Mbarështrimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave

Mbarështrimi i pyjeve është planifikimi afatmesëm e afatgjatë në nivel ekonomie pyjore e më gjerë, i cili siguron përmbushjen e kërkesave ndaj pyllit duke mbajtur parasysh aspektet ekologjike, ekonomike e sociale. Ai do të përfshijë:

- 1- grumbullimin e informacionit,
- 2- përcaktimin e objektivave të planit të mbarështrimit në lidhje me mbarështrimin e ekonomisë pyjore
- 3- përcaktimin e masave në nivel parcele pyjore dhe në nivel ekonomie
- 4- monitorimin e zbatimit të punimeve në aspektin kohor dhe hapsinor

Si bazë për mbarështrimin shumë funksional për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë do të jenë të dhënat që do të sigurohen nga matjet në terren gjatë fazës së inventarizimit nëpërmjet sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme. Në hartimin e planit të mbarështrimit, nënparcela është njësia më e vogël ku bazohemi në vlerësimin, planifikimin, dhe analizimin e kushteve të stacionit dhe të grumbujve pyjore, përcaktimin e objektivave dhe masave specifike.

Objektivat specifike të planit të mbarështrimit do të jenë:

- 1- Vazhdueshmëria e prodhimit pyjor
- 2- Rritja e prodhimtarisë së grumbujve pyjorë në ekonomi
- 3- Vlerësimi i gjëndjes reale të burimeve pyjore dhe kullimore në termat sasiorë (volumi, rritja në volum, mundësia e shfrytëzimit, produktet drusore dhe jodrusore) dhe cilësore (gjëndja vegetative, cilësia e lëndës drusore, vitaliteti)

3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Bazuar në të dhënat e përshkrimit parcellar dhe në të dhënat e vlerësimit në terren rezultoi se në ekonominë pyjore Gomsiqe, ekzistojnë këto klasa/kategori të përdorimit të tokës (Tabela 2).

Tabela2. Të dhëna mbi përdorimin e tokës në ekonominë pyjore Gomsiqe

Përdorimi territorit	Sipërfaqja(ha)
Pyll	4700.2
Sip Inproduktive(shkembore)	643.8
TokeBujqësore	1847.5
Kullote/livadh	815.0
Urban	159.1
Toke me bimesipyjore	477.2
Sip Djerr	123.7
TOTALI	8766.4

3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Forma e qeverisjes në të cilën futen grumbujt pyjore të ekonomisë Gomsiqe, sipas mbarështimit aktual dhe të propozuar jepet nga tabela si më poshtë.

Planet e hershme të mbarështimit e Inventarizimit të ekonomisë pyjore Gomsiqe sipas funksionit i ndanin pyjet me funksion prodhues, mbrojtës, prodh+mbrojtës, shkurre.

Pjesa më e madhe e pyjeve të ekonomisë pyjore Gomsiqe, janë trajtuar si cungishte, ndërsa diferenca si trungishte (Pyllëzimet me pishë te zeze).

Destinacioni kryesor i tyre ka qënë sigurimi i druve të zjarrit, lëndës së ndërtimit, barit për blegtorinë




Figure 2. Format e qeverisjes së pyjeve në ekonominë pyjore Gomsiqe

Nga paraqitja grafike e mësipërme rezulton se forma dominuese e qeverisjes së pyjeve në këtë ekonomi pyjore janë Trungishtet qe perfaqesohen nga pyjet artificial te dominuar nga pisha e zeze, cungishtet zene nje pjese te konsiderushme dhe perfaqesohen nga Bunga, Qarri, Shkoza e bardhë. Shkurret mesdhetare dominohen dëllinja e kuqe, Shqopa, Mareja, frashëri I bardhë, etj.

3.1.3. Ndarja e ekonomise pyjore ne parcela dhe nenparcela

Më poshtë po japim listën e ngastrave pyjore që janë pjesë e ekonomise pyjore Gomsiqe për të cilin është hartuar edhe plani i mbarështrim

Tabela 3. Lista e ngastrave pyjore në ekonominë pyjore Gomsiqe sipas funksionit

Emrilokal	Parcela	N/parcela	Siperf	Perdorimi	Forma Qeverisja
Shpatet e mehajve	1	.	50	Pyll	Trungisht
Puke	2	a	132	Urban	Urban
Mehaj	2	b	6.9	Pyll	Trungisht
MbiMehaj	3	b	14.98	Pyll	Cu
MbiMehaj	3	a	21.49	Pyll	Tr
Helde	4	a	31.26	Pyll	Tr
Helde	4	b	10.5	Pyll	Tr
Mehaj	4	c	23.62	Urban	Urban
MbiMehaj	5	d	14.63	Bujqesi	Bujqesi
MbiMehaj	5	a	62.66	Pyll	Tr
Maja e Arcanit	5	b	11.08	Pyll	Cu
